



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr. 10/1, datë 07 janar 2019

**PËR SHPALLJEN E VENDEVE VAKANTE PËR PROKURORË NË PROKURORINË E
POSAÇME KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR**

Në përputhje me nenin 6 dhe nenit 7 te Ligjit nr. 95/2016 *Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar*, nenit 159 të ligjit nr. 115/2016 *"Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë"* si dhe ligjit 96/2016 *"Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë"*, Këshilli i Lartë i Prokurorisë

VENDOSI:

Neni 1

Të shpallë fillimin e procedurave për plotësimin e 15 vendeve vakante për prokurorë në Prokurorinë e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (SPAK) përmes procedurës së ngritjes nw detyrw.

Neni 2

Të miratojë kriteret shtesë që duhet të plotësojnë kandidatët për prokurorë në SPAK, të cilat i bashkëlidhen kushteve të detyrueshme ligjore sipas legjislacionit në fuqi. Shqyrtimi i aplikimeve do të fillojë vetëm pas miratimit dhe publikimit të kriterëve shtesë.

Neni 3

Te caktojë Komisionin e Përhershëm të Zhvillimit të Karrierës me përgjegjësinë që të hartojë projekt rregulloren me procedurat dhe kriteret shtesë që do të zbatohen në përzgjedhjen e anëtarve të SPAK dhe të ndjekë e zbatojë procedurat paraprake për plotësimin e kushteve nga kandidatët.

Neni 4

Njoftimi i vendeve vakante si dhe kriteret që duhet të plotësojnë kandidatët do të publikohen në faqen zyrtare të institucionit.

Neni 5

Shprehja e interesit duhet të bëhet jo më vonë se 30 (*tridhjetë*) ditë kalendarike nga shpallja e thirrjes në faqen zyrtare të institucionit dhe të dorëzohet në adresën:

Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Rruga "Qemal Stafa" Nr. 1, godina e Prokurorisë së Përgjithshme, Tiranë

Mbi zarf duhet të shënohet: "Shprehje Interesi për prokuror për në SPAK".

Gjithashtu mund të dorëzohet dhe në formë elektronike në adresën: vendevakante@klp.al (në këtë rast të gjitha dokumentat duhet të jenë të skanuara bashkëlidhur kërkesës për aplikim).

Shprehja e Interesit duhet të përmbajë shpjegimet e kandidatit për arsyet e kandidimit (*letra e motivimit jo më shumë se 3 faqe A4*).

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

